

Përmbledhje mbi të rejat më të fundit

Kujtesë për individët, subjekt i deklarimit të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave

Të gjithë individët rezidentë në Republikën e Shqipërisë, të cilët gjatë vitit 2019 kanë realizuar të ardhura, nga të gjitha burimet, në shumën mbi 2,000,000 lekë, brenda datës 31 Korrik 2020 duhet të dorëzojnë në mënyrë elektronike, nëpërmjet sistemit e-filing, Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA).

Detyrimin për dorëzimin e Deklaratës Individuale Vjetore e të Ardhurave (DIVA) e kanë gjithashtu edhe individët jo rezidentë, të cilët realizojnë të ardhura të tatueshme, me burim në Republikën e Shqipërisë, në shumën mbi 2,000,000 lekë.

Të ardhurat e tatueshme, të detyrueshme për t'u deklaruar nga individët, subjekt deklarimi, janë:

- Të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit;
- Të ardhurat bruto nga dividendi;
- Të ardhurat bruto nga qiraja;
- Fitimi kapital nga shitja e pasurisë së palujtshme në pronësi të deklaruesit;
- Të ardhura bruto nga interesat bankare;
- Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të palujtshme;
- Shuma bruto të fituara nga lotaria apo lojëra të tjera të fatit;

- Të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuritë e tjera, që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike;
- Fitimi kapitali nga dhurimi;
- Të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart.

Për herë të parë, deklarata do të gjenerohet e paraplotësuar automatikisht me të dhënat e të ardhurave vjetore bruto nga pagat apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët, si edhe me përlogaritjen e Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi.

Gjithashtu fushë e paraplotësuar do të jetë edhe vlera e paguar gjatë vitit për sa i takon Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi.

Rubrikat e mësipërme të dekaratës DIVA, pavarësisht se do të gjenerohen të paraplotësuar, do të vijojnë të jenë fusha të lira dhe të ndryshueshme, në mënyrë që deklaruesi të ketë mundësi t'i verifikojë dhe ndryshojë ato.

Akt Normativ nr. 29, datë 15.7.2020 “për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave vendosi:

- Në ambiente të mbyllura publike dhe tregtare duhet të përdoret barriera mbrojtëse (maskë), sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e Institutit të Shëndetit Publik, të miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.
- Mospërdorimi i barrierës mbrojtëse (maskë) nga individët në ambiente të mbyllura, publike dhe tregtare, dënohet me gjobë në masën 2 000 (dy mijë) lekë.
- Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj pike janë inspektoratet përgjegjëse sipas fushës së tyre të

përgjegjësisë për individët në ambientet publike dhe tregtare, ndërsa Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake për individët në transportin publik dhe në mjedise të tjera të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë”.

Udhëzues i Institutit të Shëndetit Publik “Mbi përdorimin e barrierave mbrojtëse/maskave në ambientet e mbyllura publike dhe tregtare”

Qëllimi i këtij udhëzuesi është përcaktimi i vendeve ku do të përdoren barrierat mbrojtëse (maskat), si edhe i kriterëve të përshatshmërisë së tyre dhe mënyrës së përdorimit në ambiente të mbyllura publike dhe tregtare, nga individët në komunitet, me qëllim zvogëlimin të transmetimit të mundshëm të COVID-19. Për sa më sipër:

1. Barriera mbrojtëse/maska duhet të përdoret nga të gjithë individët me përjashtim të fëmijëve deri në 10 vjeç.
 2. Maska nuk duhet të hiqet apo të ulet poshtë zonës së rekomanduar kur bashkëbisedohet.
 3. Përdorimi i maskës në ambientet e mbyllura duhet të konsiderohet si masë plotësuese dhe jo si zëvendësim i masave kryesore parandaluese që rekomandohen për të zvogëluar transmetimin në komunitet, përfshirë distancën fizike, qëndrimin në shtëpi, kur jeni të sëmurë, respektimin e etiketës respiratore, higjienën e përpiktë të duarve dhe shmangien e prekjes së fytyrës, hundës, syve dhe gojës.
- Ambientet ku është i detyrueshëm përdorimi i barrierës mbrojtëse/maskës: “Ambient i mbyllur” është:
 - a) një ambient që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar plotësisht me mure dhe çdo lloj materiali tjetër të përhershëm ose të përkohshëm;
 - b) një ambient, që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar me mure të përhershme ose të përkohshme, muret e të cilat kanë hapje të përhershme, që nuk mund të

hapen apo të mbyllen, me sipërfaqe më pak se 50 për qind e sipërfaqes së përgjithshme të mureve.

- Ambientet e mbyllura publike dhe tregtare ku është e detyrueshme mbajtja e barrierës mbrojtëse/maskës përfshijnë:
 - të gjitha ambientet e mbyllura;
 - të gjithë administratën publike dhe jopublike;
 - transportin publik;
 - zyra, banka, farmaci;
 - të gjitha qendrat tregtare, dyqanet;
 - të gjitha supermakatat, tregjet dhe njësitë e shërbimit.

Përdorimi i saktë i barrierës mbrojtëse/ maskës

- Pastroni duart me sapun dhe ujë ose dezinfektues duarsh me bazë alkooli përpara se të vendosni dhe të hiqni barrierën mbrojtëse/maskën e fytyrës.
- Barrierë mbrojtëse/maska e fytyrës duhet të mbulojë plotësisht fytyrën nga ura e hundës deri poshtë në mjekër.
- Evitoni prekjen e barrierës mbrojtëse/maskës gjatë kohës që e mbani të veshur.
- Kur hiqni barrierën mbrojtëse/maskën e fytyrës, hiqeni atë nga pas, duke shmangur prekjen e përparme të saj.
- Hidhni barrierën mbrojtëse/maskën e fytyrës në mënyrë të sigurt në koshin e mbetjeve.
- Lani duart ose aplikoni dezinfektuesin me bazë alkooli menjëherë pasi të hiqni barrierën mbrojtëse/maskën e fytyrës.
- Barrierë mbrojtëse/maska jomjekësore, prej tekstili e larë, e ripërdorshme duhet të lahet sa më shpejt që të jetë e mundur pas çdo përdorimi, duke përdorur larës të zakonshëm në 60°C.
- Maska është personale dhe nuk ndahet me asnjë person tjetër.



Heqja e gjobave të vendosura për mospagim të kësteve paraprake të Tatimit mbi Fitimin gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19

Në vijim të masave të marra për zbatimin e lehtësive fiskale për tatimpaguesit, gjatë situatës së emergjencës COVID-19, Administrata Tatimore ka përcaktuar procedurat e nevojshme për heqjen e gjobave të vendosura për shkak të mospagimit në afat të kësteve paraprake të Tatimit mbi Fitimin për 3-mujorin e parë 2020, të cilat janë llogaritur dhe kontabilizuar gjatë muajve Prill – Qershor 2020, periudhë e cila korrespondon me gjendjen së fatkeqësisë natyrore të shpallur me VKM nr.243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, i ndryshuar.

Tatimpaguesit, të cilët i kanë paguar tashmë gjobat e vendosura për sa më sipër, do të kenë mundësi që shumën e paguar ta përdorin për pagesën e detyrimeve tatimore të mëvonshme. Drejtoritë Rajonale Tatimore do të vijojnë me zbatimin e procedurave përkatëse dhe tatimpaguesit do të njoftohen në llogarinë e tyre të deklarimit elektronik, e-filing.

